

URDHËR
Nr. 621, datë 17.10.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2 të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrisë përgjegjëse për arsimin për realizimin e procedurave të mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të atyre që ndjekin programet e fushave prioritare, sipas udhëzimit nr. 27, datë 2.8.2022, “Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar”, tek Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

2. Financimi i studentëve realizohet sipas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit mbikëqyr realizimin e procedurave nga Agjencia Kombëtare e Arsimit të Lartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi